

# SHPALLJE ANKANDI

## BASHKIA MIRDITË NJOFTIMI I ANKANDIT

1. Autoriteti shitës: Bashkia Mirditë  
Adresa “sheshi Abat Doçi”
2. Data e zhvillimit të ankandit 18.03.2024 ora 10.00
3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit

Ankandi do të zhvillohet me procedurë të hapur.

4. Objekti i Shitjes: Dhënie me qira të katit të parë të pasurisë nr.13/196 ZK 3244, Rubik, me sipërfaqe 120.66 m<sup>2</sup>, (Qendra për produktet agro dhe artizanatin, pranë infokullës Rubik), në pronësi të Bashkisë Mirditë.
5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes; Objekti është i ndërtuar në një truall 1000 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e objektit është 120.66 m<sup>2</sup>. Objekti është në pronësi të Bashkisë Mirditë. Ky objekt është përfituar sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Austria-Albania Partnerschaft (AAP-Marianne Graf) “Për ngritjen e qendres për produktet agro dhe artizanatin”. Bazuar në këtë marrëveshje Bashkia Mirditë duhet të pajisë dhe vërë në funksion objektin sipas misionit të përcaktuar.

Kati i parë i objektit është 120.66 m<sup>2</sup>. Kati i parë ka një sallë të madhe e konceptuar si dhomë ekspozimi i produkteve, tre dhoma për punë artizanale dhe dy dhoma për magazinim dhe zyrë. I gjithë ambjenti i objektit është i pa arreduar. Arredimi i saj do të bëhet sipas sipas konceptit që parashikon misioni i ngritjes së objektit, të hartuar nga AAP-Marianne Graf .

Subjekti që do kontraktohet për ofrimin e shërbimit duhet të vazhdojë aktivitetin sipas misionit të ndërtimit të këtij objekti. Të krijojë produkte artizanale me motive të zonës, të krijojë produkte ushqimore me bazë prodhimet e zonës dhe ti etiketojë ato në një logo që identifikon prodhimet mirditore. Të arredojë mjediset e objektit sipas detajimeve dhe modelit të ofruar nga AAP-Marianne Graf, si dhe duhet të pajiset me licencat përkatëse sipas ligjeve në fuqi; të vendosë punonjës për prezantimin e produkteve në showroom; të prezantojë produktet me origjinë mirditore në tregun e gjërë brenda dhe jashtë vendit.

6. Vlera Fillestare është llogaritur sipas VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar”. Për katin e parë (përdhe) të ndërtesës/strukturës, vlera dysheme për dhënien me qira është: sipërfaqja 120.66 m<sup>2</sup> = 12 066 Lek/Muaj.  
Për sipërfaqen funksionale, (oborr, ambjent parkimi) vlera dysheme për dhënien me qira është: 8 793 Lek/Muaj.
7. Vendi i zhvillimit te ankandit: (Adresa:)  
Bashkia Mirditë, zyra juridike dhe e prokurimeve publike

8 Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:

18.03.2024 ora 10.00, ofertat duhet të jenë të hartuara në gjuhën shqipe.

9. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës

Dokumente me pagesë:

	Po	X	Jo	<input type="checkbox"/>
Nëse Po	Monedha	Lek	Çmimi	1000

Dokumentet standarde të ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit

**BASHKIA PEQIN**  
NJOFTIMI I ANKANDIT

1. Autoriteti shitës: Bashkia Peqin, Bulevardi “Mustafa Gjinishi”, Peqin, e-mail: info@peqini.gov.al”, faqja e internetit - www.peqini.gov.al, nr.tel. +355696697990
2. Data e zhvillimit të ankandit: 18.3.2024
3. Lloji i Procedurës standarde të ankandit”: Procedurë e hapur
4. Objekti i Shitjes: Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Shkumbini” Sh.A në masën 80%;
5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes: Klubi i futbollit Shkumbini Sh.A është shoqëri e organizuar në formën e shoqërisë aksionere e krijuar në vitin 2011, ku aksionet zotërohen në